 

# Happy 4Th of July



Të dashur miq,
Sot është 4 Korriku, Dita e Pavarësisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Me këtë rast, dëshiroj t'u uroj të gjithë shqiptaro-amerikanëve:
Gëzuar 249-vjetorin e shpalljes së Pavarësisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës!

Dy ditë më parë, Sekretari i Shtetit amerikan njoftoi mbylljen e fondit të ndihmave amerikane të USAID-it.
Personalisht, e mbështes këtë vendim për dy arsye:

**1.** Siç u shpreh edhe Sekretari Rubio, fondet e USAID-it, në shumë vende të botës, në vend që të nxisnin pro-amerikanizmin, shpesh kanë nxitur anti-amerikanizmin. Ne shqiptarët e dimë më mirë se kushdo tjetër se çfarë është bërë dhe për çfarë janë përdorur ato fonde ndër vite.

**2.** Sepse në gjithë veprimtarinë time kërkimore – që përfshin mbi 120 libra, studime historike, artikuj, zbulime arkivore, si dhe aktivitete diplomatike e kulturore të lidhura me Amerikën, përfshirë përkthimin dhe botimin e veprave të autorëve amerikanë në dobi të marrëdhënieve shqiptaro-amerikane – nuk kam aplikuar, përfituar apo shfrytëzuar asnjë fond, as nga USAID-i, as nga ndonjë agjenci tjetër e huaj. Kjo më bën të ndihem i lirë, i lumtur dhe krenar për këtë veprimtari.

**3.** Për mua kjo nënkupton se ata që hiqen sikur e duan Amerikën, shpesh nuk e duan atë për vlerat dhe ndihmën që ajo historikisht i ka dhënë popullit tonë, por për interesa financiare dhe për përdorim abuziv të mjeteve që ajo i ka ofruar bujarisht Shqipërisë.

**PO RENDIS MË POSHTË DISA PREJ AKTIVITETEVE QË KAM REALIZUAR NDËR VITE.**

**Gëzuar Ditën e Pavarësisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës!**
**Zoti e bekoftë Amerikën dhe miqësinë e përjetshme midis shqiptarëve dhe amerikanëve!**



**“DITA E INAUGURIMIT TË SELISË SË AMBASADËS AMERIKANE NË TIRANË.”**

**DITA HISTORIKE E FALËNDERIMEVE**

E enjte, 27 nëntor 1930 – E enjte, 27 nëntor 2024

“Ngjarja më piktoreske e ndodhur kohëve të fundit në Ballkan.”

(New York Times – 28 nëntor 1930)



E enjtja e fundit e nëntorit, çdo vit, shënohet si “Dita e Falënderimeve “ nga populli amerikan. Janë qindra mijëra shqiptaro – amerikanët që sot festojnë Ditën e Falënderimeve bashkë me miqtë dhe fqinjët e tyre amerikanë, në atdheun e tyre të dytë, Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Me këtë rast të veçantë, dëshiroj t’u uroj të gjithëve:

Gëzuar këtë ditë kaq të veçantë dhe të dashur për popullin amerikan!

## NJË HISTORI E HARRUAR LAVDIE – MIQËSIA SHQIPTARO-AMERIKANE



Rënia e avionit amerikan **C-53D** më 8 nëntor 1943 shënoi rastin e parë dhe të fundit gjatë Luftës së Dytë Botërore që një grup infermierësh, ushtarakësh dhe pilotësh amerikanë të rrëzoheshin me avion në një zonë të pushtuar nga nazistët gjermanë dhe të arrinin të shpëtonin. Kjo ngjarje ndodhi në Shqipëri.

Ka shumë kombe në botë që krenohen për virtytet e tyre njerëzore, por pak prej tyre mund të dëshmojnë një histori si kjo – një akt mikpritjeje dhe shpëtimi, që dëshmon për fisnikërinë dhe bujarinë e popullit shqiptar.

## NJE AMERIKAN I DASHURUAR ME SKENDERBEUN DHE BARLETIN




David Hosaflook është me origjinë nga Teksasi, SHBA, por 23 vitet e jetës së tij në Shqipëri e kanë bërë të ndiejë vetën po aq shqiptar sa edhe amerikan.

Shqipja që ai flet është kristalore, e pastër dhe pa asnjë ndikim dialektor. Ai jo vetëm që e njeh mirë gjuhën tonë, por është gjithashtu i dashuruar pas historisë sonë, sidomos me figurën e Gjergj Kastriotit – Skënderbeut dhe me veprën monumentale të Marin Barletit....

## PRO-AMERIKANËT DHE PSEUDO–PROAMERIKANËT



Reforma kaloi. Por përgjigjja e pyetjes themelore mbetet ende pezull: Kush janë vërtet proamerikanët dhe kush janë antiamerikanët në Shqipëri...?

## ERICKSON DHE BERNSTEIN – DY AMERIKANË QË NA DONIN ME SHPIRT

Nga Miho Gjini, Mjeshtër i Madh, kritik arti, teatri dhe letërsie

*Botuar në gazetën "Shekulli", më 26 korrik 2018*

## CHARLES TELFORD ERICKSON DHE HERMAN BERNSTEIN NË PENËN E MAL BERISHËS




Duke lexuar dy monografi të shkruara nga ish-Ambasadori i Shqipërisë në Mbretërinë e Bashkuar dhe Irlandë, z. **Mal Berisha** – njëra kushtuar misionarit **Charles Telford Erickson**, tjetra diplomat-it **Herman Bernstein** – ndeshemi me dy figura të jashtëzakonshme amerikane, që i kanë dhënë një kontribut të rrallë Shqipërisë në periudha vendimtare të historisë sonë. Këto vepra nuk janë thjesht studime historike, por dëshmi të dashurisë së pastër dhe të përkushtimit të këtyre dy personaliteteve ndaj vendit tonë....

## KUMTESË "CHARLES TELFORD ERICKSON – AMERIKANI QË I KUSHTOI JETËN SHQIPËRISË"

*Një reflektim mbi jetën, veprën dhe trashëgiminë e misionarit amerikan që la gjurmë të pashlyeshme në historinë e arsimit, bujqësisë dhe miqësisë shqiptaro-amerikane.*






...Përpara një audience të gjerë dhe të nderuar, z. Berisha referoi mbi jetën dhe veprën e misionarit amerikan **Charles Telford Erickson**, një personalitet që ia kushtoi jetën Shqipërisë, duke dhënë një kontribut të pazëvendësueshëm në arsim, bujqësi dhe në forcimin e marrëdhënieve shqiptaro-amerikane...

## MAL BERISHA: ANGLO – AMERIKANËT PËR NE SHQIPTARËT – NË FONDACIONIN M&M IVANAJ



New York – Tiranë

# <u>Mal Berisha: ANGLO – AMERIKANËT PËR NE SHQIPTARËT - Mal Berisha</u>

# SHEMBET SHKOLLA BUJQËSORE AMERIKANE “CHARLES TELFORD ERICKSON” NË GOLEM TË KAVAJËS

***Shkruar nga Mal Berisha***



…E themeluar më 20 shtator 1925, kjo shkollë – së bashku me Shkollën Teknike “Harry Fultz” – përbënte një nga dëshmitë e para të investimeve amerikane në Shqipëri. Ajo u kthye në një vatër të rëndësishme arsimore, nga e cila dolën mijëra agronomë, veterinerë, zooteknikë dhe specialistë të fushës së bujqësisë…

Themelet e saj ishin ngritur mbi një donacion prej **10.000 dollarësh**, një akt bujarie dhe vizioni që synonte zhvillimin afatgjatë të Shqipërisë rurale dhe arsimimin profesional të rinisë shqiptare.…

## SYRI TV – “KAFE SHQETO”

## KUSH E SHEMBI NDËRTESËN E SHKOLLËS BUJQËSORE AMERIKANE “CHARLES TELFORD ERICKSON”?




**Titulli i episodit:**

**I ftuar special:**

**Mal Berisha** – diplomat, studiues dhe autor i veprës kushtuar Charles T. Erickson

**Tema:**

Pse u shkatërrua një nga dëshmitë më të hershme dhe më të rëndësishme të marrëdhënieve shqiptaro-amerikane?

# MAL BERISHA: NJË PENG NDERI PËR KONGRESMENIN AMERIKAN ELIOT ENGEL



...Pas një karriere 32-vjeçare si anëtar i Dhomës së Përfaqësuesve në Kongresin Amerikan, **miku i çmuar i shqiptarëve**, kongresmeni i njohur **Hon. Eliot Engel**, nuk arriti të rizgjidhet në primaret e Partisë së tij, Partia Demokratike e SHBA-së. Largimi i tij nga Kongresi shënon fundin e një epoke të përkushtimit të palëkundur ndaj çështjes shqiptare – në Kosovë, Shqipëri, Maqedoninë e Veriut dhe kudo ku shqiptarët kanë kërkuar zë dhe mbështetje...

Ky largim më sjell një **peng nderi personal**, që lidhet me dëshirën dhe përpjekjen time për të shprehur, në mënyrë institucionale dhe të denjë, mirënjohjen e kombit shqiptar për këtë burrë shteti, i cili dha aq shumë për të drejtat tona dhe për përforcimin e marrëdhënieve shqiptaro-amerikane..

## NJË TAKIM MIQSH QË STUDIOJNË VLERAT E TRASHËGIMISË SHQIPTARO–AMERIKANE

*Nga Mal Berisha*



Më 9 gusht 2021, në një nga ambientet e Hotel "Tirana International", pata kënaqësinë të takoj studiuesen e njohur **Eleni Laperi** – një njohëse e thellë e marrëdhënieve shqiptaro-amerikane dhe e figurave që i kanë dhënë vlerë kësaj lidhjeje... Eleni më foli me pasion për **Rose Wilder Lane** dhe **Rexhë Metën**, ndërsa unë ndava me të përvojat e mia kërkimore për **Charles Telford Erickson**, **Herman Bernstein** dhe udhëtarët amerikanë që përshkruan Shqipërinë në faqet e revistës **"The National Geographic Magazine"** – vepra tashmë të botuara dhe në duart e lexuesit....

## NJË BUST DINJITOZ PËR CHARLES TELFORD ERICKSON AMERIKANI QË IA KUSHTOI JETËN SHQIPËRISË

***Nga Mal Berisha***




**Si u njoha me Charles Telford Erickson?** Ishte viti **1999**, kur mora pjesë në ceremoninë përkujtimore të **90-vjetorit të gazetës "Dielli"**, në New York. Pata nderin të mbaja një kumtesë përpara anëtarëve të **Federatës Pan-Shqiptare "Vatra"**, e cila kishte qenë për dekada të tëra strehë dhe zë i fuqishëm i çështjes shqiptare në Shtetet e Bashkuara.

Gjatë përgatitjes për këtë kumtesë, hasa për herë të parë në emrin **Charles Telford Erickson** – një emër që në atë kohë për mua ishte pothuajse i panjohur, por që shumë shpejt do të kthehej në një nga figurat më frymëzuese të studimeve të mia mbi marrëdhëniet shqiptaro-amerikane. Zbulova se ky misionar amerikan, i ardhur në Shqipëri në fillim të shekullit XX, nuk kishte sjellë me vete vetëm ndihmën materiale, por mbi të gjitha një **vizion për edukim, zhvillim dhe dinjitet kombëtar**...

## PËR NDER TË PËRVJETORIT TË 81 – të TË LINDJES SË ISH – KONGRESMENIT AMERIKAN ME ORIGJINË SHQIPTARE JOSEPH DIOGUARDI






Kujtime nga veprimtaria në shërbim të Lidhjes Qytetare Shqiptaro–Amerikane
(1995–2001)

# MARJANA BULKU: AMBASADORI I "PUSHTETIT TË BUTË" DHE AMERIKA – MIKE E SHQIPTARËVE



## Mal Berisha – Një ambasador që punon me pasion për historinë dhe miqësinë shqiptaro-amerikane

Mal Berisha është një ambasador që nuk ndalet së punuari – ai takon miq të zakonshëm dhe të jashtëzakonshëm, hulumton me kujdes historinë tonë nëpër burime shpesh të anashkaluara, kërkon në arkiva alternative dhe nxjerr në dritë fakte të rëndësishme për marrëdhëniet mes Shqipërisë dhe botës, sidomos me Shtetet e Bashkuara të Amerikës...

# MAL BERISHA: VOTONI DR. MEHMET OZ PËR SENATIN AMERIKAN!




**Si u njoha me Dr. Mehmet Oz?**

Në nëntor të vitit 2001, ndërsa shërbeja në Kosovë si pjesë e stafit të Kombeve të Bashkuara, u përballa papritmas me një diagnozë tronditëse: një aneurizëm në aortë që mund të më shkaktonte vdekje të menjëhershme. Ishte një çast i errët në jetën time, kur gjithçka varej në një fije.

Falë ndihmës së miqve dhe angazhimit të disa personaliteteve shqiptaro-amerikane, u bë e mundur që unë të udhëtoja drejt SHBA-së dhe të trajtohesha në **Qendrën Mjekësore të Universitetit të Kolumbias**, në Nju Jork. Pikërisht aty, për herë të parë, takova **Dr. Mehmet Oz**, i cili në atë kohë ishte një prej kirurgëve më të shquar të zemrës në Amerikë...

# SUKSESET E SAPRANOS SHQIPTARO–AMERIKANE ME FAMË BOTËRORE ERMONELA JAHO



*Shkruan: Mal Berisha*

**"Nëse ju vetë nuk e gjeni veten në muzikë, as publiku nuk do ta gjejë veten tek ju."**
**— *Ermonela Jaho***

...Sukseset e sopranos shqiptaro-amerikane **Ermonela Jaho**, tashmë prej vitesh nuk përbëjnë më një lajm të befasishëm. Ajo ka ngjitur shkallët më të larta të artit operistik botëror, duke pushtuar skenat më prestigjioze të muzikës klasike në Europë, Amerikë dhe përtej. Zëri i saj prek zemrën, interpretimi i saj tejkalon teknikën dhe bëhet ndjenjë e pastër. **Ermonela** nuk është vetëm një artiste virtuoze, por edhe një ambasadore dinjitoze e kulturës shqiptare në botë. Në çdo paraqitje të saj, ajo bart me vete përulësinë e origjinës dhe fisnikërinë e artit të madh...

# DY LIBRA PËR DY AMERIKANËT QË NA DONIN ME SHPIRT



*Nga Miho Gjini*

Thuajse e kisha harruar fare Malin – ish-studentin tim të Institutit të Arteve – kur papritur, ai u shfaq para meje në njërën nga rrugët e Tiranës dhe më përqafoi përzemërsisht, sikur koha nuk kishte kaluar fare, sikur asgjë nuk kishte ndryshuar. Nuk e dija se sapo ishte kthyer nga një përvojë e rëndësishme diplomatike dhe akademike jashtë vendit…

# **<u>KËSHILLI I AMBASADORËVE AMERIKANË SJELL NJË VËSHTRIM TË PLOTË RRETH SITUATËS NË SHQIPËRI</u>**




KËSHILLI I AMBASADORËVE AMERIKANË
ORGANIZATA DIPLOMATIKE BI–PARTIZANE MË PRESTIGJIOZE NË SHBA DHE NË BOTË
SJELL NJË VËSHTRIM TË QARTË, TË PLOTË DHE TË PAANSHËM MBI SITUATËN NË SHQIPËRI

Raporti i Misionit në Ballkan – Maj 7–14, 2023

Në maj të vitit 2023, një delegacion prej dhjetë anëtarësh të Këshillit të Ambasadorëve Amerikanë (*Council of American Ambassadors – CAA*), i shoqëruar nga bashkëshortë, të ftuar dhe staf ndihmës, zhvilloi një vizitë zyrtare në Ballkan, me fokus të veçantë në Shqipëri.

# MEHMET ÖZ – DOKTORI QË MË SHPËTOI JETËN 23 VJET MË PARË, EMËROHET ANËTAR I KABINETIT TË PRESIDENTIT AMERIKAN DONALD TRUMP

***Nga Mal Berisha***




...Pas 23 vitesh nga momenti kur mjeku i njohur amerikan me origjinë turke, Dr. Mehmet Öz, më shpëtoi jetën me profesionalizëm dhe humanizëm të rrallë, ai emërohet sot si pjesë e kabinetit të Presidentit Donald Trump.

Ky emërim është jo vetëm një vlerësim i aftësive të tij si kirurg dhe figurë publike, por edhe një dëshmi se vlerat njerëzore dhe angazhimi i sinqertë në shërbim të komunitetit nuk mbeten pa u njohur në jetën publike amerikane...

# SAGA SHQIPTARE NË PENËN E DISA AUTORËVE ANGLO-AMERIKANË




SAGA SHQIPTARE NË PENËN E DISA AUTORËVE ANGLO-AMERIKANË

Nga Mal Berisha

**LIBRI "CHARLES TELFORD ERICKSON" I MAL BERISHËS, NË BIBLOTEKËN E KONGRESIT AMERIKAN**



WASHINGTON D.C:  Mbas promovimit në kuadër të aktiviteteve për 100 vjetorin e Pavarësisë së Shqipërisë, të librit "Charles Telford Erickson", me autor Mal Berishën, dhe daljes në qarkullim të këtij libri interesimi dhe jehona që ka pas ky libër ka qenë jashtëzakonisht i madh në mesin e lexuesve brenda dhe jashtë Shqipërisë. Bibloteka e Kongresit, librin "Charles Telford Erickson", me autor [...]

## NË TIRANË U PROMOVUA LIBRI “CHARLES TELFORD ERICKSON”, ME AUTOR MAL BERISHA.



Në kuadër të aktiviteteve për 100 vjetorin e Pavarësisë së Shqipërisë,javen qe shkoi është promovuar libri “Charles Telford Erickson”, me autor Mal Berishën. I pranishm në këtë aktivite, Ambasadori i SHBA-së në Tiranë, Aleksandër Arvizu përgëzoi autorin Mal Berisha për librin ndërsa vlerësoi figurën e Charles Telford Erickson. “Ai e deshi Shqipërinë dhe i përkushtoi jetën e tij për këtë [...]

## NË 100-VJETORIN E PAVARËSISË, MAL BERISHA E “SJELL” SËRISH NË SHQIPËRI CHARLES TELFORD ERICKSONIN




Promovohet vepra e Mal Berishës “Charles Eerikson. I pranishëm kryeministri Berisha dhe ambasadori i SHBA-së në Tiranë Arvizu/ Në këtë 100 vjetor të pavarësisë së Shqipërisë misionari amerikan që i ka shërbyer Shqiperisë, shqiptarëve, duke dhënë një kontribut të pakrahasueshëm në fushën e pedagogjisë, Charles Erikson, vjen si një dhuratë në këtë muaj, përmes librit të autorit Mal Berisha. Në [...]

# LIBRAT ME ZË NË SHQIP, OSE AUDIOBOOKS.AL




...Librat me Zë në Shqip, ose Audiobooks.al Para disa kohësh është lëshuar në internet në gjuhën shqipe një program që njihet me emrin "Audiobooks" ose i shqipëruar "Librat me Zë". Kjo është bërë falë kontributit që i ka dhënë publikut pronari dhe drejtuesi i kompanisë së sigurimeve Sigal Uniqa Group Austria, z Avni Ponari. Ky program në internet iu jep [...]

# NDERIM PËR ATË QË UA RISOLLI ERICKSONIN SHQIPTARËVE




...Në përpjekjet e vazhdueshme që bëhen nga historianë, shkrimtarë apo dhe të tjerë për të pasqyruar rrugën e gjatë dhe të mundimshme të popullit tonë, historinë e tij ndërshekullore, figurat e shquara që kanë luajtur role të ndryshëm në këtë histori, sjellja e jetës dhe veprës së amerikanit Charles Telford Erikson, e asaj pune të jashtëzakonshme që ai bëri për Shqipërinë, ka një vlerë të veçantë, sepse ai, Eriksoni, si askush tjetër bëri aq shumë dhe ne i detyrohemi shumë...

# FEDERATA PAN-SHQIPTARE E AMERIKËS "VATRA" ORGANIZOI PROMOVIMIN E LIBRIT TË AMBASADORIT MAL BERISHA: "CHARLES TELFORD ERICKSON – JETA DHE VEPRA PËR SHQIPËRINË DHE NË SHQIPËRI"




"Mal Berisha, aktualisht ambasador i Republikës së Shqipërisë në Mbretëri të Bashkuar dhe në Republikën e Irlandës, për të gjithë ata që e njohin e kuptojnë fare mirë se ndonëse ai është një diplomat i arrirë, përmes këtij botimi ai vjen dhe si një studiues, një person që merret me meditimin", ka thënë ambasadori i SHBA, në Tiranë z. Aleksandër [...]

## SHQIPËRIA JUGORE OSE EPIRI I VERIUT NË ÇËSHTJET EUROPIANE NDËRKOMBËTARE




SHQIPËRIA JUGORE OSE EPIRI I VERIUT NË ÇËSHTJET EUROPIANE NDËRKOMBËTARE   Kliko ketu – Lexo librin… Copyright 1926 By StanfordUniversity Press All rights reserved Published, December 1926 In the United States of America. Përktheu nga  origjinali:        Mal Berisha Stamboll, Gusht 1997 Parathënie e autores Ndërkohë që Lufta e Madhe po shkonte drejt mbarimit të saj, u bë e qartë […]

## SHQIPTARËT, EUROPIANËT MË TË LASHTË DHE MË TË RINJ



## ZËRI I AMERIKËS: INTERVISTË ME STUDIUESIN MAL BERISHA



Studiuesi Mal Berisha sapo ka botuar një libër me 3 vëllime mbi jetën dhe veprat e misionarit amerikan, **Charles Telford Erickson**. Ai ka patur një ndikim të madh në jetën e Shqipërisë në fillim të shekullit të kaluar. Erikson ka komunikuar rregullisht me presidentin amerikan Udrou Uillson gjatë periudhës më të vështirë, kur rrezikohej ekzistenca e shtetit shqiptar. Zëri i [...]

## SHPËTIMI NË SHQIPËRI, SHKRUAR NGA HARVEY SARNER, PERKTHEU MAL BERISHA




Shpëtimi në Shqipëri, shkruar nga Harvey Sarner, një filantrop amerikano – hebrej, është një pasqyrë historike shumë e veçantë ku tregohet se si shqiptarët e rrezikuan jetën e vet për t'i mbrojtur hebrejtë shqiptarë dhe ata të huaj gjatë kohës së Holokaustit. Raportet se si danezët dhe bullgarët morën mbi vete rrezik të madh për t'i shpëtuar bashkëqytetaret e vet [...]

## FAN NOLI QËNDRON NË ALTARIN E HISTORISË



Nga Mal Berisha Fjala e mbajtur ne simpoziumin kushtuar jetes dhe vepres se Fan Nolit ne Boston me 22 Nëntor, 2015 I nderuar Reverand At Liolin! I nderuar Dr Gjon Bucaj, Kryetar I Vatres Të dashur pjesëmarrës! Mirdita! Është një nder i madh të gjëndem sot në Boston, në këtë epiqendër të kulturës dhe trashëgimisë shqiptaro – amerikane. Në këtë [...]

# KOHA JONE: MAL BERISHA FLET PËR HERMAN BERNSTEIN, NDAJNË DASHURINË PËR SHQIPËRINË



## TAKIM ME 103 VJEÇAREN GREJS JOHNSON ERICKSON



TAKIM ME 103 VJEÇAREN GREJS JOHNSON ERICKSON
Boston 26 Mars 2014 Hyrje Të takosh njerëz për të cilët ke dëgjuar por nuk i ke parë kurrë është gjithmonë një kënaqësi e veçantë. Mund të jenë ata njerëz të thjeshtë, të njohur në distancë, mund të jenë artistë, njerëz të medias, shkencetarë, shkrimtarë e pse jo edhe politikanë. Në takimet me njerëzit përherë të mbetet diçka në mëndje: mund të jetë pamja, mënyra e shprehjes, sa i afërt ose [...]

## “SHQIPTARËT, LISA MBI TRUALLIN ILIR”, NJË TESTAMENT SHQIPTARIE




“Shqiptarët, lisa mbi truallin ilir”, një testament shqiptarie
Nga Marjana Bulku Zeneli TIRANA OBSERVER,01/08/2016
Nëpër ditët tona të vështira,pikërisht atëherë kur e ardhmja tronditet e i trembet së nesërmes, ekzistojnë alternativa ku krenaritë jetojnë jo vetëm nëpër fjalë, por edhe në vepra që kryevepra i bën koha kur na serviren, mesazhet që ato përcjellin dhe efektet që shkaktojnë ndër ne. [...]

# INTERVISTË ME MAL BERISHA PËR CHARLES T. ERICKSON NË SHQIPËRI




Ambasadori shqiptar për Britaninë e Madhe, Mal Berisha, flet për jetën dhe veprimtarinë e Charles Telford Ericksonit, misionar protestant amerikan i cili shërbeu në Shqipëri dhe për çështjen shqiptare që nga 1908. Versioni i plotë....

## NË STUDION E PROFESOR JOSEPH S. NYE, JR.

Në studion e Profesor Joseph S. Nye, Jr. KOHA JONE: 04/02/2017 Biseda me profesor Nye rreth teorisë së tij të "Pushtetit të Butë" ishte shumë interesante. Pashë që zbatimi i asaj teorie në praktikën dhe përvojën time diplomatike ishte në përputhje me tezat e Profesorit... Nga Mal Berisha Prej shumë vitesh jam i apasionuar pas teorisë së Profesorit Harvardian Joseph [...]






Gazeta Standard, 12 Mars, 2017 "U befasova nga eksperienca, zgjuarsia dhe njohuritë e Z. Mal Berisha. Ne patëm një bisedë interesante. Ishte një takim dhe bisedë shumë e mirë. Ai të lë një përshtypje shumë të fortë në favor të pushtetit të butë në Shqipëri." . Ky është komenti që Prof. Joseph Samuel Nye, Jr., i John F. Kennedy School of [...]

# LIBËR I RI I AUTORIT MAL BERISHA – HERMAN BERNSTEIN AMBASADOR I SHBA – VE NË MBRETËRINË SHQIPTARE 1930 – 1933




HERMAN BERNSTEIN Ambasador i ShBA – ve në Mbretërinë Shqiptare 1930 – 1933 Libër i ri i autorit Mal Berisha Këto ditë, në Panairin e Librit në Tiranë, autori Mal Berisha u paraqit me librin e tij më të ri me titullin e mësipërm. Në faqen e pasme të librit, autori shkruan: “Herman Bernstein ishte një njeri universal i kohës [...]

## LIBËR PËR NJË MENDJENDRITUR



Libër për një mendjendritur GAZETA SHQIPTARE 05.01.18 Nga MONIKA STAFA Me shkas nga libri “Herman Bernstein, ambasador i SHBA-së në Shqipëri (1930-1933), i M. Berishës “Vendi mban një pozitë të rëndësishme në Adriatik. Në Shqipëri, edhe Lindja edhe Perëndimi i rrudhin krahët, si në pak vende të tjera…Mikpritja proverbiale dhe sensi i nderit nuk janë përkeqësuar në procesin e marshimit […]

## ZERI I AMERIKES – INTERVISTË ME AUTORIN E LIBRIT "HERMAN BERNSTEIN"




Zeri i Amerikes – Intervistë me autorin e librit "Herman Bernstein" Një libër i ri i autorit Mal Berisha botuar kohët e fundit në Shqipëri për herë të parë flet hollësisht për një hebre të shquar amerikan, të quajtur Herman Bernstein, që shërbeu si përfaqësues i Shteteve të Bashkuara në Mbretërinë e Zogut nga viti 1930 deri në 1933. Kliko [...]

## KOHAVISION – COSMO SHQIPTARET NE NATIONAL GEOGRAPHIC: INTERVISTE ME MAL BERISHEN

Prej vitit 1908 deri më 2000, revista e famshme amerikane National Geographic ka botuar rreth dhjetë reportazhe për Shqipërinë dhe shqiptarët. Të mbledhur nga diplomati dhe studiuesi Mal Berisha dhe të rrëfyera nga gazetari Durim Abdullahu në magazinën televizive COSMO, këta artikuj përcjellin përditshmërinë e shqiptarëve në vitet 1908, 1909, 1912, 1918, 1931, 1980, 1990 dhe 2000…

## MAL BERISHA SJELL NE VATER HERMAN BERNSTAIN




Mal Berisha sjell ne Vater Herman Bernstain Ambasadori amerikan në Shqipëri në vitet 1930-1933 bashkon në vatër perspektiva e këndvështrime historike që kanë qenë në drithije për 50 vjet. Marrdhëniet shqiptaro-amerikane janë jetike për kombet e vegjël që duan ti mbijetojnë tranzicioneve . “Herman Bernstain, ambasador në vitet 1930-33” nga ish -diplomati Mal Berisha në Albanian Culture TV...

# MAL BERISHA PREZANTON NË DURRËS LIBRIN: HERMAN BERNSTEIN, AMBASADOR I SHBA – VE NË MBRETËRINË SHQIPTARE, 1939-1933




Nga Shefqet Kërcelli Në klubin e arteve “Sigal” në Durrës, u zhvillua promovimi i librit më të fundit të ish-ambasadorit Mal Berisha, titulluar ‘Herman Bernstein”, Ambasadori Amerikan në Shqipeëi. Në këtë aktivitet morën pjesë dhjetra qytetarë durrsakë, intelektualë, studiues, gazetarë, krijues, miq të botuesit, etj.  Fillimisht shkrimëtari i mirënjohur durrsak bëri një prezantim të shkurtër të aktivitetit studimor dhe botues […]

## ÇMIMI I GAZETËS “DIELLI” PËR REPORTAZHIN MË TË MIRË” IU DHA Z. MAL BERISHA” DIELLI QË NGROH VATRËN”




ÇMIMET E GAZETES DIELLI PER KONKURSIN E 110 VJETORIT – NJOFTIM ZYRTAR I JURISË PER NDARJEN E ÇMIMEVE TË KONKURSIT PËR 110 VJETORIN E GAZETËS “DIELLI” – Në darkën e organizuar me 6 Prillt 2019 kushtuar 110 Vjetorit të Gazetës “DIELLI” u shpallën fituesit e Konkursit organizuar nga VATRA & Redaksia e DIELLIT me rastin e 110 vjetorit, ku morën […]

## MAL BERISHA – SHQIPJA JONË NË FJALORIN E GJUHËVE TË BOTËS TË ANDREW DALBY – it




Mal Berisha  Studiues SHQIPJA JONË NË FJALORIN E GJUHËVE TË BOTËS TË ANDREW DALBY – it. Columbia University Pres Hyrje – Kush është Andrew Dalby  Në "Fjalorin e Gjuhëve", botuar nga Columbia University Press në New York, 1998, në mes të 400 gjuhëve të botës përfshihet edhe gjuha shqipe, si një ndër gjuhët më të vjetra indo-evropiane. Kjo gjuhë zë [...]

## FONDACIONI MARTIN & MIRASH IVANAJ – NJË XHEVAHIR KULTURE DHE DIJE NË MES TË TIRANËS



FONDACIONI MARTIN & MIRASH IVANAJ – NJË XHEVAHIR KULTURE DHE DIJE NË MES TË TIRANËS Një Vegim i largët rreth emrit "Mirash" Ishte viti 1959 kur u ula në bangën e klasës së parë të shkollës fillore "Asim Vokshi", në Tropojë. Ajo ishte një shkollë e vogël e themeluar në vitin 1923, pas dy shkollave tjera të hapura në rrethin […]

# MIKU I MADH I SHQIPTARËVE, DIPLOMATI I NDERSHËM DHE I DREJTË HERMAN BERNSTEIN

**NJË FALENDERIM PËR STUDIUESIN SHPENDI HULËSI TOPALLAJ**




Prej vitesh kam mësuar se edhe Libri është si puna e verës që pijmë: Sa më shumë kalon koha, aq më shumë i rritet shija. Edhe pse botimi i librit kushtuar Ambasadorit Amerikan në Mbretërinë Shqiptare, 1930-1933, HERMAN BERNSTEIN u bë disa kohë që është botuar, herë pas here ai kap [...]

# INTERVISTË ME Z. MAL BERISHA PËR CHARLES T. ERICKSON NË SHQIPËRI




Institute for Albanian & Protestant Studies – December 2nd, 2014 Ambasadori shqiptar për Britaninë e Madhe, Mal Berisha, flet për jetën dhe veprimtarinë e Charles Telford Ericksonit, misionar protestant amerikan i cili shërbeu në Shqipëri dhe për çështjen shqiptare që nga 1908. Versioni i plotë. Intervistë me z. Mal Berisha për Charles T. Erickson në Shqipëri

# MIKU ME I MADH I SHQIPTAREVE | ABC STORY

Miku me i madh i shqiptareve | ABC Story Në fillesat e shtetit, ne shqiptarët kemi pasur fatin të ndihmohemi nga disa miq të fuqishëm. Ishin njerëz të cilët nga larg orientonin vëmendjen e superfuqive të Botës, që ndërhynin në vendimmarrje nga ato që lëviznin kufij shtetesh, i ngushtonin apo zgjeronin, qoftë sipas rrethanave apo bindjeve të momentit. Ne tashmë [...]

# **PRESIDENTI W. J. CLINTON – LUFTA E KOSOVËS 1998–1999**




VLERËSIM PËR VEPRËN E BEJTULLAH DESTANIT DHE MBËSHTETJEN E HARRY BAJRAKTARIT PËR LIBRIN "PRESIDENTI W. J. CLINTON – LUFTA E KOSOVËS 1998–1999" Mal Berisha, 23 Mars 2025 Pak ditë më parë, në Prishtinë, doli nga shtypi një botim me vlera të rralla historike dhe simbolike, i titulluar: "PRESIDENTI W. J. CLINTON – LUFTA E KOSOVËS 1998–1999: FJALIME DHE PARAQITJE MEDIATIKE." [...]

## PREZANTIMEVE NË QENDRA TË NDRYSHME AKADEMIKE

## YIVO INSTITUTE OF JEWISH RESEARCH NEW YORK




PËRMBLEDHJE E PREZANTIMEVE NË QENDRA TË NDRYSHME AKADEMIKE, UNIVERSITARE, DIPLOMATIKE DHE HISTORIKE, RRETH VLERAVE TË POPULLIT TONË DHE LIDHJEVE TONA ME KULTURËN PERËNDIMORE. – RRËNJET TONA: Muzeu Historik Kombëtar – Tiranë; – CHARLES TELFORD ERICKSON – Amerikani që i kushtoi jetën Shqipërisë, Tiranë, Londër, New York; – HERMAN BERNSTEIN, Ambasadori Amerikan në Mbretërinë Shqiptare, 1930 – 1933 – YIVO Institute [...]

## ME STUDIUESIN E NJOHUR IDRIZ LAMAJ, FOTOGRAFIN FADIL BERISHA DHE INTELEKTUALEN MARJANA ZENELI BULKU



ME STUDIUESIN E NJOHUR IDRIZ LAMAJ, FOTOGRAFIN FADIL BERISHA DHE INTELEKTUALEN MARJANA ZENELI BULKU.  Nga Mal Berisha Gjatë këtyre ditëve në New York, kam mbledhur një numër intervistash me dëshmitarë  rreth  një figure të ndritur të Malësë së Gjakovës dhe të kombit tone:  Cucë Avdylen e Gegëhysenit.  Për këtë kam takuar disa njerëz me vlera të veçanta të bashkësisë shqiptaro […]

# NJË DITË E VEÇANTË NË BOSTON, ME AT ARTHUR LIOLIN



NJË DITË E VEÇANTË NË BOSTON, ME AT ARTHUR LIOLIN
TEK KRYEKISHA ORTODOKSE SHQIPTARE E SHËN GJERGJIT
Nga Mal Berisha Ishte nder dhe kënaqësi e veçantë të takoja përsëri dhe të zhvilloja një bisedë të gjatë me plot dashuri vëllazërore me At Arthur Liolin: Kreu i Kryekishës dhe Ikona e Patriotizmës Shqiptare.  Ai ka mbajtur ndezur zemrat e patriotëve shqipëtarë [...]

# NJË DITË ME VEPRIMTARIN E ÇËSHTJES TONË KOMBËTARE, Z. HARRY BAJRAKTARI, NË NEW YORK



NJË DITË ME VEPRIMTARIN E ÇËSHTJES TONË KOMBËTARE, Z. HARRY BAJRAKTARI, NË NEW YORK Nga Mal Berisha Në vijim të punës për një serial dokumentar, këto ditë në New York pata një takim dhe një intervistë me Veprimtarin e njohur të Çështjes tonë Kombëtare, z Harry Bajraktari, në qendrën e tij të punës në Tarrytown, në veri të New York-ut. [...]

## AFËRDITA HALL – XHAFO – CHARLES TELFORS ERICKSON U "HARRUA"NGA ZYRTARËT E DIKTATURËS, POR JO NGA SHQIPTARËT




Meditime rreth librit: "JETA E JASHTËZAKONSHME E AMERIKANIT CHARLES TELFORD ERICKSON KUSHTUAR SHQIPËRISË" e autorit Mal Berisha.   Shkruar nga Afërdita Hall – Xhafo, (E bija e ish nxënësit të Erickson – it, Avdyl) Xhafo). St Louis, ShBA. Nuk gjej fjalë të shpreh ato ndjenja të forta krenarie dhe dhimbjeje deri në palcë, që më pushtuan gjatë leximit të këtij [...]

## ASGJË NUK DUET T'I SHPËTOJË SYRIT E VESHIT TË DIPLOMATIT

Federata Pan – Shqiptare e Amerikës, VATRA, promovoi librin "Ambasador i Pushtetit të Butë" i autorit Mal ...

## FRANK SHKRELI: RETH LIBIRT AMBASADORI I "PUSHTETIT TË BUTË" TË AUTORIT MAL BERISHA




AMBASADORI I "PUSHTETIT TË BUTË" Nga Frank Shkreli Me rastin e promovimit të librit Ambasadori i Pushtetit të Butë, e autorit Mal Berisha, ish-Ambasadorit të Shqipërisë në Mbretërinë e Bashkuar Është kënaqësi që gjëndem përsëri në Qëndër të Federatës Pan-Shqiptare Vatra – themeluar nga dy prej penave më të ndritura të letrave shqip, Peshkop Fan Nolit dhe Faik Konicës, ambasadorit [...]

# “AMBASADOR I PUSHTETIT TË BUTË”, PROMOVIM MADHËSHTOR NË VATËR




New York më 15 Mars 2022 Federata Panshqiptare e Amerikës Vatra organizoi një promovim madhështor të librit të Ambasador Mal Berishës “Ambasador i pushtetit të butë”. Studiues, vatranë, miq, media, artistë, diplomatë e personalitete shqiptare në diasporë, drejtues shoqatash të komunitetit shqiptar në New York e më […]

## MAL BERISHA: VLERA UNIVERSALE E PUSHTETIT TË BUTË – (SOFT POWER)







VLERA UNIVERSALE E PUSHTETIT TË BUTË (SOFT POWER) DHE MUNDËSITË QË I JEP KJO TEORI PROMOVIMIT TË BOTËS SHQIPTARE Teorisë filozofike të njohur si PUSHTETI I BUTË në Diplomaci, (SOFT POWER) të krijuar prej Profesorit amerikan Joseph Samuel Nye, i kam kushtuar një ndër punët më voluminoze të jetës, librin: AMBASADOR I PUSHTETIT TË BUTË. Nga mënyra sesi kjo teori [...]

# DALIP GRECA – NJË AMBASADOR I PUSHTETIT TË BUTË SI DIPLOMATI MAL BERISHA




Një Ambasador i Pushtetit të Butë si diplomati Mal Berisha Nga Dalip GRECA* Libri që promovojmë sot në Vatër ”Ambasador i Pushtetit të Butë” i diplomatit par excellence Mal Berisha mendoj se i kalon kufijtë e një ditari me shënimet dhe mbresat e një diplomati. Ai është më shumë se kaq, është një libër për dashurinë dhe devocionin ndaj Kombit, [...]

# AMBASADOR MAL BERISHA: – “KRISTO FLOQI, KOHA DHE VEPRA E TIJ LETRARE”, NJË PUNË MONUMENTALE NË SHËRBIM TË HISTORISË SË ARTIT DRAMATIK DHE LETËRSISË SHQIPE




“Kristo Floqi, koha dhe vepra e tij letrare”, një punë monumentale në shërbim të historisë së artit dramatik dhe letërsisë shqipe Nga Mal Berisha Pas një jave, vi pësëri në Selinë e Vatrës i mbushur plot me gëzim dhe frymëzim. Kjo për disa arësye: E para, ndjeva një kënaqësi shumë të madhe gjatë promovimit të librit tim të radhës AMBASADOR [...]

## TO THE DEAR HEAD OF THE ST. GEORGE'S ALBANIAN ORTHODOX CHURCH AND THE PARISHIONERS!



Mal Berisha Tiranë, Albania
Website: Berisham@gmail.com To the head of the St. George's Albanian Orthodox Church, in Boston, USA Dear head of the St. George's Albanian Orthodox Church and the parishioners! I learned with sadness and pain about the passing away of your honorable father, my dear friend and the man who led with full dignity the St. George [...]

## PËRSIATJE ME RASTIN E FESTIMEVE TË 111 VJETORIT TË SHPALLJES SË PAVARËSISË BRENDA NË SALLËN E PARLAMENTIT TË BASHKISË SË NJU JORKUT



Përsiatje me rastin e festimeve të 111 vjetorit të shpalljes së Pavarësisë brenda në Sallën e Parlamentit të Bashkisë së Nju Jorkut. NGA MAL BERISHA ÇFARË ËSHTË EKUMENIZMI PËR NE SHQIPTARËT? Kremtimi i 111 vjetorit të shpalljes së Pavarësisë së Shqipërise brenda në sallën e Parlamentit të Bashkisë së Nju Jorkut ishte një rast ideal për të parë se sa [...]

# “APOSTULLI” I  ILIR IKONOMIT NË NEW YORK




“APOSTULLI” I  ILIR IKONOMIT NË NEW YORK Përshtypje personale NGA PROMOVIMI I LIBRIT APOSTULLI I ILIR IKONOMIT NË NEW YORK Nga Mal Berisha HYRJE Duket qartë se edhe pas afro dy muajsh që nga ditët e Panairit të Librit 2023 në Tiranë, emri i mirë që bëri libri APOSTULLI i autorit Ilir Ikonomi vazhdon të jehojë tashmë edhe në anën [...]

## NOTES ON ALBANIA – EDICIONI I 4-T NË NEW JERSEY – USA




Notes on Albania – Edicioni i 4-t në New Jersey – USA "NOTES ON ALBANIA 4" 9 janar 2025. "NOTES ON ALBANIA 4", ishte një ngjarje shumëdimensionale, e iniciuar dhe organizuar nga diplomati Mal Berisha, anëtar i Këshillit Kombëtar të Partisë Demokratike të Shqipërisë. Ajo mblodhi më 9 janar 2025, në studion e artit ODR, ku përgatitet artistja jonë e [...]

## PROF. DR. GJOVALIN SHKURTAJ FLET PËR LIBRIN *MALET E GJIGANTËVE*, SHKRUAR NGA PROF. DR. CARLETON S. COON DHE PËRKTHYER NË SHQIP NGA MAL BERISHA.




Dr. Carleton S. Coon lindi më 23 qershor 1904. Ai konsiderohet si një nga antropologët më të rëndësishëm amerikanë të shekullit të 20-të. Në vitin 1925 kur ishte vetëm 24 - vjeç ai u diplomua për antropologji me Medalje të Artë në Universitetin e Harward - it. Në vitin 1928, ai u emërua profesor i antropologjisë pranë këtij Universiteti. Coon ka shërbyer si dekan i Fakultetit të Antropologjisë në Harvard dhe për një kohë të gjatë ka qenë President i Shoqatës së Antropologëve të Shteteve të Bashkuara. ...

